

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Furnizim me karburant

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

09100000-0;

VLERA E FONDIT LIMIT: 350,000,000 (treqind e pesdhjetë milion) Lekë pa TVSH ekuivalente në EUR, 3,733,333 (tre miliona e shtatëqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) Euro kursi i kembimit valutor 93.75 ALL/EURO nga banka e Shqiperise te dates 13.07.2026, vënë në dispozicion nga te ardhurat e Eco Tirana sha me objekt: Furnizim me karburant per Eco Tirana sha.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Eco Tirana sh.a. ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, nenit 27, 28 ,29, 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. **Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

Ky kriter plotësohet nëpërmjet dorëzimit të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës së Formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vërtetim nga organet tatimore, për xhiron vjetore për vitet financiare 2024, 2025 ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 70% e vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros vjetore autoriteti kontraktor i është referuar VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Seksionit III, Neni 43 pika 2, gërma (a).

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.26/2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore të çertifikuara të paraqitura pranë autoriteteve tatimore përkatëse, për vitet financiare 2024 dhe 2025, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit për Kontabilitetin dhe raportimin financiar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

(Shënim: ky kriter vendoset vetëm në rastet kur vlerësohet nga autoriteti/enti kontraktor)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në Ligjin nr.29/ 2023, datë 2.05.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe VKM Nr. 922, datë 29.12.2014 *PËR DORËZIMIN E DEKLARATAVE TATIMORE DHE TË DOKUMENTEVE TË TJERA TATIMORE, VETËM NËPËRMJET FORMËS ELEKTRONIKE* (Ndryshuar me VKM nr. 211, datë 9.4.2025).

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore , ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore , dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 30 % të vlerës së fondit limit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Referuar VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” nenit 40 pika 4 ku është përcaktuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Shënim: Autoretit /enti kontraktor mund të kërkojë edhe:

2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1. Subjekti duhet të deklarojë, se merr përsipër furnizimin në stacione të shitjes së karburanteve me pakicë me shërbim 24 orë në të gjitha pikat e tij në qytetin e Tiranës, edhe me kartë elektronike të personalizuar me targën e çdo automjeti të Autoritetit Kontraktor, dhe/ose bot, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor në momentin e lidhjes së kontratës dhe se kartat elektronike do të jenë pa skadencë dhe të konsumueshme gjatë vitit.

2.4.2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Certificate Regjistrim marke.

2.4.3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizat të lëshuara nga ISHTI brenda 6 muajve nga data e hapjes së ofertave.

2.4.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë listën e stacioneve të shitjes së karburanteve me pakicë në qytetin e Tiranës të paktën 10, në të gjithë qytetin e Tiranës. Për këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontrate noteriale ose akt pronesie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKB, etj.), të jenë të pajisur me Leje mjedisore lëshuar nga QKL, sipas legjislacionit në fuqi.

2.4.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim të lëshuar nga ISHTI ku të vërtetohet se operatori ekonomik nuk ka patur penalitete për shkelje të cilësive për vitin 2023,2024,2025.

2.4.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim teknik për respektimin e normave dhe kushteve teknike në stacionet e tregtimit të karburanteve lëshuar nga autoriteti përkatës i akredituar.

2.4.7. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ofrojë një faqe menaxhimi të karburanteve të cilën duhet ta prezantojë ditën e hapjes së ofertave, ku furnizimi dhe shpenzimi i karburantit për automjetet, në rastin kur të kërkojë nga Autoriteti Kontraktor, të kryhet nëpërmjet kartës elektronike, si dhe të krijojë mundësinë e shërbimit të ngarkimit të sasive të karburantit nga operatori ekonomik drejt Autoritetit Kontraktor, me qëllim që rimbushja e kartave elektronike të personalizuar me targën e mjetit si dhe administrimi i sasive të karburanteve të kryhet nga vetë Autoriteti Kontraktor. Faqja duhet të mundësojë shërbimin e furnizimit me karburant nëpërmjet kartave elektronike, pulla të cilat ngjiten në xhamin e automjetit dhe ofrojnë shërbimin e furnizimit me karburant vetëm për atë automjet.

2.4.8. Operatori ekonomik duhet te dorezoje Autorizim të ushtrimit të aktivitetit (Tregtim me pakicë karburantesh) e lëshuar nga Njësia Vendore dhe që plotëson kushtet e legjislacionit në fuqi per te pakten 2 stacione te shitjes së karburanteve.

Argumentim: Në bazë të pikës 5 gërma a) , pikës 6 gërma c), pikës 8 të nenit të 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar dhe nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Kërkesa që furnizimi në të gjitha pikat brenda qytetit të Tiranës, synon garantimin e vazhdimësisë së shërbimit për autoritetin kontraktor , gjithashtu dhe personalizimi i kartave me targa specifike për secilin automjet të autoritetit kontraktor siguron: Transparencë në përdorim dhe kontroll shpenzimesh gjithashtu dhe Gjurmueshmëri të përdorimit të karburantit, që është një standard ne kontrollet e brendshme .

Kjo certifikatë dëshmon që operatori ekonomik ka të drejtë ekskluzive ligjore për të përdorur markën e tij dhe se nuk cenon të drejtat e subjekteve të tjera.

Lista e stacioneve funksionale në qytetin e Tiranës siguron shtrirje gjeografike të përshtatshme, që përputhet me nevojat logjistike të AK.

Kërkesa për vërtetim nga ISHTI, është një mënyrë për të siguruar që operator ka një historik të pastër të përputhjes me standardet teknike e të cilësisë, veçanërisht në sektorin e furnizimit me karburant.

Kriteri ka për qëllim të garantojë që operatori ekonomik ka kapacitetet, përvojën dhe strukturat fizike minimale të nevojshme për të përmbushur kërkesat e kontratës. Duke kërkuar të paktën dy stacione të autorizuar të shitjes, autoriteti kontraktor synon: Siguri ligjore dhe teknike për tregtimin me pakicë të karburanteve, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi. Kapacitet dhe disponueshmëri se operatori ekonomik ka kapacitet të mjaftueshëm për shpërndarje, furnizim dhe logjistikë, duke garantuar cilësi dhe vazhdimësi në ofrimin e karburantit.

(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kriteret e tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë)

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në

*përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Hartimi i specifikimeve teknike është kryer nga Eco Tirana sh.a. referuar Ligjit Nr. 162 dt 23.12.2020, i ndryshuar dhe VKM Nr. 285 date 19.05.2021 dhe duke iu referuar kërkesave dhe nevojave të autoritetit kontraktor Eco Tirana sh.a. në fushën e veprimtarisë së tij, referuar blerjeve të mëparshme dhe zonës ku ushtron aktivitetin në bazë të kontratës së shërbimit të administrimit të mbetjeve urbane dhe zgjerimit të shërbimit në zona të reja.